



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Njoftim publik

05-015/02-149133/25 dt. 12/03/2026

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës duke u bazuar në kërkesën 05-015/02-149133/25 dt. 30/09/2025, e aplikuesit Granit Krasniqi nga fsh. Bardhosh, Prishtinë si dhe Neni 2, 7 dhe 8 të Ligjit Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave, Vendimin 01 nr. 031 -223419 të Kuvendit të Komunës së Prishtinës dhe Neni 6, pika 1.2., pika 1.2.1., pika 1.2.1.2. dhe pika 1.2.2., Neni 7, pika 1, pika 2 dhe pika 3 të Udhëzimit Administrativ Nr. 17/2019 të MMPH – së, ka iniciuar dhe proceduar emërtimin e rrugës së re, rruga me kod të veçantë (kodi 14221) dhe ka bërë propozimin për emërtim të rrugës, Fshatin Bardhosh, Prishtinë.

Emrat e propozuar:

AHMET HOXHA – Dëshmorë. **ETEM SYLA** – Dëshmorë. **HYSEN SYLA** – Dëshmorë.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 12.03.2026 deri më 20.03.2026, në E-mail adresën: urbanizmi@prishtine.gov.net

Në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 17/2019 të MMPH –së, për krijimin dhe administrimin e listës alfabetike për emërtime, listës rezervë dhe vendosjen e tyre nga regjistri komunal, neni 7, paragrafët 1 dhe 2, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në web-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në web-faqe të Komunës.

Në të gjitha komentet tuaja duhet të përshkruhet numri i kërkesës të shënuar më lartë si dhe kodi i rrugës përkatëse.



Nënshkrimi i Zyrtarit: